



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI” REKTORI

Njoftim për shpallje konkursi të brendshëm

Në Rektoratin e Universitetit të Elbasanit “Aleksander Xhuvani”, shpallet konkurs i brendshëm, për personel ndihmësakademik me karakter administrativ. Kandidatët e interesuar, punonjës të kategorisë personel ndihmësakademik dhe administrativë, me kohë të plotë të UE-së, që plotësojnë kriteret e përgjithshme e të posaçme etj, në respektim të rregullores në fuqi, miratuar me Vendimit nr. 70 datë 17.11.2025 “Për miratimin e rregullores për plotësimin e vendeve të lira të punës të kategorisë personel ndihmësakademik në Universitetin e Elbasanit “Aleksander Xhuvani” të Senatit Akademik, gjejnë informacionin e mëposhtëm:

Kategoria: personel ndihmësakademik me karakter administrativ.

Pozicioni i punës: Specialist i protokoll arkivës, niveli i mesëm në zbatim.

Specialisti i protokoll arkivës, është përgjegjës për krijimin, regjistrimin ruajtjen, shërbimin, dorëzimin e dokumenteve hyrëse dhe dalëse në Institucion; bashkëpunon ngushtë me personelin e sektorit në arritjen e objektivave dhe realizimin e detyrave dhe përgjegjësi; ndjek realizimin e afateve, të dorëzimit të dokumenteve dalëse; propozon zgjidhje profesionale në veprimtarinë e përditshme; përgjigjet tek përgjegjësi i sektorit/drejtori;

Kandidati duhet të plotësojë këto kriteret të përgjithshme e të posaçme:

Kritere të përgjithshme:

- Të jetë shtetas shqiptar dhetë ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna, që nuk është shuar sipas legjislacionit në fuqi;
- të plotësojë kriteret e posaçme.

Kritere të posaçme:

- Të ketë mbaruar studimet universitare të ciklit të parë Bachelor/të dytë (Master) ose ekuivalente me të, në shkenca shoqërore. Diplomat të cilat janë marrë jashtë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI” REKTORI

vendit, duhet të jenë të njohura dhe njësuara nga ministria përgjegjëse për arsimin;

- Të ketë përvojë pune;
- Të ketë trajnime në fushën e arkivave;
- Të ketë përvojë pune mbi një vit në pozicionin e kërkuar;
- Të jetë njohës i një prej gjuhëve të huaja të BE-së;
- Të ketë aftësi të mira menaxhuese, komunikuese e të punës në grup.

Kandidatët e interesuar, në respektim të pikës **d** dhe **e** të nenit 6 “Konkursi i brendshëm” të Vendimit nr. 70 datë 17.11.2025 “Për miratimin e rregullores për plotësimin e vendeve të lira të punës të kategorisë personel ndihmës akademik në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” të Senatit Akademik, duhet të dorëzojnë në rrugë postare në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” brenda 3 (tri) ditëve pune nga data e shpalljes në www.uniel.edu.al dokumentacionin e kërkuar si më poshtë:

- Letër interesi
- Dokumentacion shtesë, veç atyre që ndodhen në dosjen personale.

Dokumentacioni i kërkuar të dorëzohet në protokollin e Institucionit.

Konkursi do të zhvillohet në ambientet e Rektoratit. Komisioni ad-hoc do të vlerësojë paraprakisht kërkesat dhe dosjet e kandidatëve dhe më pas kandidatët do ti nënshtohen intervistës me gojë (07.04.2026 – 17.04.2026). Kandidatët konkurues do të njoftohen elektronikisht për rezultatet paraprake të konkurrimit, orën dhe datën e intervistës dhe për shpalljen/njoftimi i fituesit.